



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 192/2 Prot

Tiranë, më 14.06.2022

V E N D I M

Nr. 85, datë 14.06.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të informacionit të dërguar, me disa parregullsi të pretenduara se janë kryer nga Njësia Përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Vlorë, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”,

Vërej se:

Nëpërmjet një informacioni të regjistruar në datën 24.02.2022, protokolluar me nr. 192 prot., datë 24.02.2022, paraqitur nga nëpunësja ***** , Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni në lidhje me, pretendimin e saj se është liruar nga detyra pa të drejtë, si rrjedhojë e “moskonfirmimit të statusit të nëpunësit civil, në fund të periudhës së provës”, duke mos respektuar procedurën ligjore. Në të njëjtën kohë, në informacion është

parashtruar pretendimi tjetër se gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin e lirë, “Përgjegjës në Sektorin e Financë Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë (ku kandidat fitues është përzgjedhur punonjësja *****), janë lejuar shkelje të ligjit për të favorizuar fituesen.

Në këto kushte, për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes së informacionit në lidhje me pretendimet e parashtruara në informacionin e paraqitur nga nëpunësja *****, Komisioneri, ka vënë në dijeni institucionin Këshillin e Qarkut Vlorë, për fillimin dhe objektin e verifikimit, duke kërkuar për këtë edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e institucionit Këshilli i Qarkut Vlorë, u dërgua në mënyrë elektronike nëpërmjet e-mailit datë 18.03.2022, dokumentacioni bashkë me sqarimin përkatës në lidhje me problemin e ngritur, prej ankueses.

Pasi u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësës dhe dokumentacioni i përcjellë nga institucioni, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së plotësimit të pozicionit të punës “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë, rezultoi e vërtetuar që:

Këshilli i Qarkut Vlorë, me krijimin e vendit të lirë, si rrjedhojë e daljes në pension të një punonjëseje, në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242 datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, ka publikuar në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) procedurën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Mbi bazën e ankesës, procesi i verifikimit filloi me shqyrtimin e dokumentacionit në lidhje me pretendimin, për parregullsi gjatë procedurës së verifikimit paraprak të kriterëve të veçanta për pozicionin e publikuar si më sipër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se, me aktin nr. 1376, datë 02.08.2021, “Kërkesë për shpallje në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, njësia përgjegjëse e institucionit në fjalë, ka dërguar në portal shpalljen për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë për pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Në kriteret e veçanta të dërguara për publikim konstatohet që fillimisht si kriter kryesor është përcaktuar: “... Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master shkencor” në Financë, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi), kriter i cili më pas, me aktin nr. 1398, datë 06.08.2021, ka pësuar ndryshimin si më poshtë: , “... Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master profesional” në Financë, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Duke vazhduar me vlerësimin në lidhje me ligjshmërinë e veprimit administrativ të ndryshimit të kriterit arsimor, konstatojmë se institucioni që kishte pozicionin e lirë, ndryshimin e ka bërë duke u bazuar në vendimin nr. 765 datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura ”, në të cilin thuhet shprehimisht :

“Në rubrikën “Kërkesa të posaçme”, të ndarjes 2/2, të lidhjes 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për klasat I.1, I/2, I/3, II/1, II/2, III/1, III/2, fjalët “... Master shkencor ...” zëvendësohen me “... Master shkencor apo Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike ...”

Në këto rrethana, vlerësohet se ndryshimi i kriterit arsimor specifik për pozicionin e punës të shpallur për konkurrim, është i kryer në përputhje me dispozitat që rregullojnë në mënyrë specifike këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në rastin e publikimit, por vetëm se ky ndryshim duhej të pasyrohej jo vetëm në stendën e institucionit dhe në faqen e internetit të tij, por edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, mangësi kjo që nuk cenon vlefshmërinë e procesit të konkurrimit. Në këto rrethana i tërhiqet vëmëndja njësisë përgjegjëse të institucionit, të tregojë kujdes që një parregullsi e tillë të mos përsëritet në të ardhmen.

Duke vazhduar më tej me gjendjen e fakteve të konkurrimit në fjalë, rezulton se për lëvizje paralele nuk ka pasur asnjë pjesëmarrës, prandaj bazuar në pikën 13, Kreu II, të Vendimit nr.242 datë 18.03.2015, i ndryshuar, në përfundim të afateve të vendosura në shpalljen e publikuar, njësia përgjegjëse ka mbyllur procedurën e lëvizjes paralele pa kandidatë të kualifikuar, për të vijuar më tej me procedurën e ngritjes në detyrë.

Në vijim të kësaj procedure, me urdhërin e brendshëm nr. 49 (1441 prot.) datë 17.08.2021 “Për krijimin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e Këshillit të

qarkut Vlorë për vitin 2021”, është ngritur Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (njësia paraseleksionuese) e cila, në zbatim të nenit 22, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, ka bërë vlerësimin paraprak të dosjeve të kandidatëve që kishin aplikuar për ngritje në detyrë, nëse i plotësonin kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës të përcaktuara në shpalljen për publikim.

Në këtë fazë, rezultoi se kishte aplikuar vetëm konkurrentja *****, e cila u kualifikua për të vazhduar më tej në fazën e testimit me shkrim (*Proccerverbali i mbajtur nga NJMBNJ nr. 1457/1 datë 27.08.2021*),

Duke vazhduar më tej me analizën e rastit, nga verifikimi i dosjes personale të aplikantes, rezultoi se konkurrentja ***** plotësonte edhe kushtet minimale që kërkohen prej pikës 2, të Kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar: a) *të mos ketë masë disiplinore në fuqi (vërtetim i lëshuar nga institucioni); b) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”* ;

Konkretisht punonjësja, ***** është nëpunëse civile e konfirmuar në pozicionin e punës “*Specialist*”, pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë (*akti i deklaratimit të statusit të nëpunësit civil nr.1214 prot., datë 06.07.2021*); disponon diplomë të Nivelit Bachelor në Financë dhe Master Profesional po në Financë (*Cikël i plotë 2 vite akademike Tetor 2014 – Shtator 2016*) si dhe është studente në ndjekje të Masterit të Shkencave në Financë (*ç’ka provohet me vërtetimin e datës 13.08.2022, lëshuar nga Universiteti Ismail Qemali në Vlorë, për vitin akademik 2021-2022*), (*më tej, në vijimësi njësia e burimeve njerëzore duhet të administrojë dokumentin që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve*).

Përfundimisht, nga analiza e dokumentacionit të mësipërm, i cili materializon procedurën për plotësimin e pozicionit të punës në fjalë, nuk evidentohen shkaqe të arsyeshme që të venë në dyshim rregullshmërinë e procedurës së rekrutimit, për plotësimin e pozicionit “*Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit*”, në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Në lidhje me pretendimin tjetër, për parregullsinë e procedurës së lirimit nga shërbimi civil, pas vlerësimit negativ në përfundim të periudhës së provës, të nëpunëses *****, u konstatua se ajo, për këtë problem i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila e ka çështjen në shqyrtim.

Në këto kushe, mbështetur në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk është e nevojshme të vijojë më tej hetimi administrativ, në lidhje me këtë procedurë, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit për plotësimin e pozicionit “Përgjegjës në Sektorin e Financë-Buxhetit”, në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe meqënëse në zhvillimin e kësaj procedure administrative, nuk u gjetën shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Këshilli i Qarkut Vlorë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha